



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202003023/

Tiranë ____/____/2025

Lënda: Rekomandim për përfundimin e procedurës administrative, shqyrtimi i kërkesës së familjeve N.

Drejtuar: Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës – Vlorë
Rruga "Jordan Misja"
Tiranë

Për dijeni: Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

Adresa: Rruga "Dora D'Istra"
Tiranë

Znj. Z. N.

Email: ...

Bashkisë Himarë

Spile, Himarë

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve, nga veprimet ose mosveprimet e organeve të administratës publike, ka marrë në shqyrtim ankesën e tre vëllezërve kryefamiljarë N., banorë të fshatit Dhërmi, Bashkia Himarë, të cilët ngrenë shqetësimet se, nuk janë furnizuar me tokë në përputhje me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për Tokën", i ndryshuar, si dhe me vonesa në shqyrtimin e kërkesës së tyre nga Bashkia Himarë dhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë (DVASHK Vlorë).

Konkretisht ata informojnë se familjeve të K. N. dhe S. N. u është dhënë tokë arë, por pretendojnë se sipërfaqja që ju është dhënë, është më e vogël se sa ju takonte në zbatim të ligjit 7501, ndërsa për familjen Dh. N., informojnë se nuk i është dhënë fare tokë.

Ankuesit janë banorë të fshatit Dhërmi, Bashkia Himarë¹ dhe për të zgjidhur kërkesat e tyre, fillimisht ata i janë drejtuar kryesisë së fshatit Dhërmi dhe më pas Bashkisë Himarë, për të marrë informacion lidhur me procedurat që duhet të ndiqnin.

Ata informojnë gjithashtu se në kuadër të njoftimit publik të bërë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), mbi fillimin e procesit të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme në zonën ku ndodheshin pronat e tyre, kanë depozituar dokumentacion përkatës, që ata kishin në dispozicion, pranë Bashkisë Himarë, por duke qenë se sa ata kishin kërkuar, pavarësisht përpjekjeve të tyre, nuk kishte përfunduar brenda afateve ligjore, duke mos mundur të zgjidhnin vetë këtë çështje, kanë kërkuar në datë 18.10.2020, ndërhyrjen e institucionit tonë.

Pas regjistrimit të ankesës së mësipërme, bazuar në nenet 13, 17 shkronja “a” dhe 18 shkronja “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, institucioni ynë, nisi hetimin administrativ për këtë ankesë.

Në kuadër të këtij hetimi administrativ, fillimisht me shkresën tonë nr. K3/Z10-2 prot., datë 28.10.2020, i jemi drejtuar njëkohësisht *Bashkisë Himarë* dhe *DVASHK Vlorë*, me kërkesë për shpjegime dhe dokumentacion në lidhje me ankesën në fjalë.

Bashkia Himarë, me shkresën nr. 3583/1 prot., datë 20.11.2020, na ka informuar për ecurinë e ndjekjes së kërkesave të bëra nga tre vëllezërit N., si dhe dokumentacioni që duhej dorëzuar nga kërkuesit, për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës. Më konkretisht në këtë shkresë thuhej se, citojmë: “*Në përgjigje të kërkesës nr.3583, datë 02.11.2020 “Për informacion lidhur me ankesën e banorëve N.”*”, ju bëjmë me dije se:

- Z. S. N. ka paraqitur pranë Bashkisë Himarë kërkesat nr. 3203 prot., datë 06.10.2020, nr.3563 prot., datë 30.10.2020, si dhe nr. 3563/1 prot., datë 02.11.2020 “*Për kompensim toke*” dhe ka bashkangjitur A.M.T.P., certifikatën familjare, si dhe planet e rilevimit për parcelat që posedon dhe është i pajisur me AMTP.

- Z. K. N. ka paraqitur pranë Bashkisë Himarë kërkesat nr. 3562 prot., datë 30.10.2020, dhe nr.3562/l prot., datë 02.11.2020 “*Për kompensim toke*” dhe ka bashkangjitur vetëm certifikatë familjare 1/8/1991.

- Z. Dh. N. ka paraqitur pranë Bashkisë Himarë kërkesat nr.3564 prot., datë 30.10.2020, si dhe nr.3564/1 prot., datë 02.11. 2020 “*Për kompensim toke*”, ku ka bashkangjitur vetëm certifikatë familjare 1/8/1991.

Për sa i përket pretendimeve të tyre për diferencim në furnizimin me tokë të banorëve të fshatit Dhërmi dhe pse familja N. nuk është furnizuar, shkaqet dhe arsyet e mosveprimit nga ana jonë, ju sqarojmë se:

a) Plotësimi me tokë bujqësore përfituesve sipas ligjit 7501, datë 19.07.1991 “*Për Tokën*”, është kryer nga Komisionet e Ndarjes së Tokës në fshatra.

b) Bashkia Himarë ka plotësuar vetëm dokumentacione në zbatim të ligjit 57/2012, Vendimit nr.253, datë 06.03.2013, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatra të ish-kooperativave bujqësore*” si dhe ligjit 171/2014, Vendimin nr.338, datë 22.4.2015 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 253, datë 6.3.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes*

¹ Vërtetuar kjo me certifikatat e gjendjes familjare dt. 01.08.1991

së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatra të ish-kooperativave bujqësore”.

Në zbatim të ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, të gjitha dosjet do ti përcillen Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (A.SH.K.) për të vazhduar procedurat. Neni 12 i ligjit 20/2020 thotë se kërkesa duhet të shoqërohet nga: a)AMTP, b) Çertifikatë familjare 1/8/1991 dhe c) Plan rilevimi nga topograf i licensuar. Këta qytetarë nuk kanë bashkëngjitur plan rilevimi ku të vërtetojnë posedimin ose përdorimin e sipërfaqeve me tokë bujqësore për tu pajisur me AMTP”.

Pas komunikimit me DVASHK Vlorë (i cili do të trajtohet me hollësi më poshtë), me shkresën tonë nr. K3/Z10-9 prot., datë 08.07.2021, i jemi drejtuar sërish Bashkisë Himarë, duke i kërkuar të na informonte nëse i kishte dërguar dosjet e familjeve N. në DVASHK Vlorë, për vazhdimin e procedurave të mësipërme.

Bashkia Himarë, me shkresën nr. 2849/1 prot., datë 21.07.2021 na ka kthyer përgjigje,² duke na informuar se i kishte dërguar dosjet e tre vëllezërve N. në ASHK Tiranë dhe DVASHK Vlorë, me shkresën nr. 585 prot, datë 15.02.2021 dhe për këtë veprim gjithashtu kishte njoftuar nominalisht edhe secilin prej tre vëllezërve (përkatësisht me shkresat nr. 585/34 prot., datë 02.04.2021; nr. 585/35 prot., datë 02.04.2021 dhe nr. 585/36 prot., datë 02.04.2021), duke na bashkëngjitur edhe fotokopje të shkresave përkatëse.

Sa i përket komunikimit me DVASHK Vlorë, duke mos pasur përgjigje për shkresën tonë nr. K3/Z10-2 prot., datë 28.10.2020, i jemi drejtuar sërish ASHK (për dijeni Bashkisë Himarë), me shkresën nr. K3/Z10-5 prot., datë 05.01.2021, duke përsëritur kërkesën tonë për shpjegime dhe dokumentacion në lidhje me ankesën në fjalë.

Edhe pas shkresës sonë të dytë nuk patëm përgjigje nga DVASHK Vlorë, ndaj me shkresën tonë nr. K3/Z10-6 prot., datë 20.04.2021, i jemi drejtuar sërish DVASHK Vlorë dhe për dijeni Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, duke përsëritur kërkesën për shpjegime lidhur me pretendimet e ankuesve.

Në vijim ASHK, me shkresa të përsëritura nr. 413/1 prot., datë 20.04.2021 dhe nr. 413/3 prot., datë 18.05.2021, drejtuar DVASHK Vlorë dhe për dijeni institucionit tonë, i kërkonte DVASHK Vlorë që, citojmë: “...pas përcjelljes nga Bashkia të kërkesave të subjekteve për pajisje me AMTP, të vijohet me trajtimin e tyre në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 20/2020...” .

Pas sa më sipër, institucioni ynë me shkresën nr. K3/Z10-11 prot., datë 26.08.2021, i është drejtuar sërish DVASHK Vlorë dhe për dijeni ASHK, me kërkesë të përsëritur për shpjegime dhe për vazhdimin e procedurave përkatëse.

Në vijim edhe ASHK, me shkresën nr. 413/5 prot., datë 21.09.2021, i është drejtuar DVASHK Vlorë dhe për dijeni institucionit tonë, ku i kujtonte DVASHK Vlorë shkresën e institucionit të Avokatit të Popullit nr. K3/Z10-11 prot., datë 26.08.2021, si dhe i kërkonte që të njoftonte: subjektet e interesuara, institucionin tonë, si dhe Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së, brenda 10 ditëve.

² Shkresë kjo dërguar për dijeni edhe tre vëllezërve N.

Në vijim, nga ana e DVASHK Vlorë, me shkresën nr. 6712/1 prot., datë 15.09.2021, i është kthyer përgjigje institucionit tonë, duke shpjeguar procedura ligjore të përgjithshme, por pa dhënë asnjë argument ligjor për mospërfundimin e procedurave administrative për rastin konkret të familjeve N.

Në rrethanat e mësipërme, institucioni ynë me shkresën nr. K3/Z10-14 prot., datë 05.11.2021, i është drejtuar sërish DVASHK Vlorë dhe për dijeni Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, duke i kërkuar shqyrtimin e menjëhershëm të rastit dhe daljen me konkluzione konkrete.

Nga ana e DVASHK Vlorë, me shkresat nr. 14722/1 prot., datë 26.10.2021 dhe nr. 13849/1 prot., datë 05.11.2021, drejtuar ASHK-së, institucionit tonë, si dhe familjeve N., kthehet në mënyrë të përsëritur një përgjigje e përgjithshme se janë ngritur strukturat përkatëse, por ato duhen trajnuar në lidhje me zbatimin e ligjit dhe se DVASHK Vlorë është në pritje të dërgimit të dokumentacionit nga ana e njësive të qeverisjes vendore dhe nuk jepet asnjë shpjegim për rastin konkret.

Duke qenë se siç informuam më sipër nga komunikimi me Bashkinë Himarë, na rezultonte se ky institucion ua kishte dërguar dosjet e tre vëllezërve N., që në muajin shkurt 2021,³ si dhe pas informacionit nga ankuesit se kërkesa e tyre nuk kishte gjetur ende zgjidhje, me shkresën nr. K3/Z10-19 prot., datë 23.01.2025, i jemi drejtuar sërish institucionit tuaj (DVASHK Vlorë) dhe për dijeni Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, duke kërkuar të na informoni për: 1. *Situatën në të cilën ndodhej shqyrtimi i kërkesës së familjeve N.?* dhe 2. *Procedurat që parashikoni të ndiqni dhe afatet ligjore konkrete, për përfundimin e shqyrtimit të këtyre kërkesave?*

Duke qenë se kjo shkresë i ishte dërguar për dijeni edhe ASHK-së, ky institucion me shkresën nr. 1620/1 prot., datë 07.02.2025, i është drejtuar DVASHK Vlorë dhe për dijeni institucionit tonë, i kërkonte DVASHK Vlorë, citojmë: *“Nëse rezulton se ky dokumentacion, vijon të jetë i depozituar pjesërisht pranë DVASHK Vlorë, kërkojmë nga ana juaj të merren masa për të rikërkuar dhe bashkëpunuar me DAMT, NJVV dhe Prefektin e Qarkut Vlorë dhe arrijtjen e përmbylljes sa më shpejt të procesit mbi dorëzimin e plotë të dokumentacionit pranë jush (kopje të njësuar dhe inventarizuar), që disponojnë institucionet përgjegjëse.... Mbi veprimet e ndërmarra nga ana juaj, të informohet institucioni i Avokatit të Popullit dhe Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së”*.

Pavarësisht sa më sipër dhe megjithëse ka kaluar një kohë mjaft e gjatë, si nga nisja e këtij hetimi administrativ (datë 18.10.2020), ashtu edhe nga shkresa jonë e fundit (23.01.2025), institucioni ynë vazhdon të mos ketë asnjë përgjigje nga DVASHK Vlorë, në lidhje me procedurat e ndërmarra për ankesën e familjeve N. dhe për më tepër nuk jemi vënë në dijeni të ekzistencës së ndonjë shkaku ligjor, i cili do të mund të justifikonte këtë situatë.

Për sa i përket objektit të hetimit të institucionit tonë, nga shqyrtimi i gjithë shkresave të administruara në kuadër të këtij hetimi administrativ, veçanërisht:

- Shkresës së Bashkisë Himarë, nr. 3583/1 prot., datë 20.11.2020, ku rezulton se Bashkia Himarë: në lidhje me kërkesën e z. Dh. N. për mospaisje me tokë, i ka kthyer përgjigje këtij të fundit, se kjo Bashki nuk është kompetente për trajtimin e kërkesës së tij për pajisjen me tokë bujqësore, citojmë: *“Plotësimi me tokë bujqësore përfituesve sipas*

³ Me shkresën nr. 585 prot, datë 15.02.2021

Ligjit 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, është kryer nga Komisionet e Ndarjes së Tokës në fshatra”

- Shkresës së Bashkisë Himarë, nr. 585/34 prot., datë 02.04.2021, drejtuar z. Dh. N., ku e njofton këtë shtetas, se i ka dërguar ASHK në Tiranë dhe DVASHK Vlorë, dokumentacionin përkatës, në të cilin nuk përfshihen AMTP (ndryshe nga dy njoftimet për dy vëllezërit e tjerë, në të cilët përfshiheshin AMTP-të), nuk rezulton dokumentacion që ankuesi Dh. N., të ketë ndjekur procedurat për tu ankuar ndaj veprimeve (apo mosveprimeve) të Komisionit të Ndarjes së Tokës në fshatra.

Për këtë arsye, nga ana e institucionit tonë është vazhduar ndjekja e ankesës vetëm për dy nga vëllezërit N. dhe më konkretisht S. dhe K.. Kjo bazuar në nenin 2, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar: “Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj...”, pasi institucioni ynë nuk ndjek hetimin administrativ, për sa kohë që nuk rezulton që shtetasi të ketë bërë përpjekje për të komunikuar me organin e administratës publike, për të cilin ai pretendon se i ka shkelur të drejtat.

- Analiza e rastit:

Nga hetimi administrativ i kësaj çështjeje na rezulton se janë shkelur afatet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në trajtimin e shqyrtimit të kërkesës së mësipërme të dy vëllezërve N.. Arrijmë në këtë konkluzion bazuar në analizën ligjore në vijim:

Ankuesit bazuar në nenin 12 “Kushtet për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, të ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, kanë depozituar në Bashkinë Himarë kërkesën e tyre, së bashku me dokumentacionin që ata dispononin.

Bashkia Himarë, bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” (ligji 20/2020), sipas të cilit: “2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, brenda 7 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcjellin pranë ASHK-së kërkesat për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, të administruara sipas ligjeve nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve” dhe nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, si dhe kërkesat e administruara sipas nenit 6 të këtij ligji”, i ka dërguar dosjet e tre vëllezërve N., në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK dhe DVASHK Vlorë, që në muajin shkurt 2021.⁴

Ndryshe nga detyrimet e parashikuara në nenin 14, pika 2, të ligjit 20/2020, sipas të cilave, “1. Kalimi në pronësi i tokës bujqësore bëhet nga ASHK-ja, sipas listës së përdoruesve të tokës, të miratuar me vendim të këshillit bashkiak. 3. Agjencia Shtetërore e Kadastrës saktëson sipërfaqen për kalim pronësie, sipas nenit 13 të këtij ligji, në konsultim me përfaqësuesit e administratës së njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe verifikon plotësimin e kushteve për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore. ASHK-ja harton listën e përdoruesve faktikë të tokës bujqësore për çdo ish-kooperativë dhe/ose ish-ndërmarrje bujqësore, të cilën ia paraqet për miratim këshillit bashkiak. ...”, ASHK nuk ka vepruar në përputhje me këtë dispozitë.

⁴ Me shkresën nr. 585 prot, datë 15.02.2021.

Me mosveprimin e mësipërm, ASHK, ka bërë të pamundur vijimin e procesit dhe më konkretisht të detyrimeve të parashikuara nga pikat 4 dhe 5, po të nenit 14, pika 2, të ligjit 20/2020, sipas të cilave: “4. Nëse këshilli bashkiak vendos rrëzimin e projektvendimit “Për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore”, ASHK-ja korrigjon përmbajtjen e listës, sipas vërejtjeve të arsyetuara të këshillit bashkiak dhe më pas ia riparaqet atij për miratim. 5. Pas miratimit të listës së përdoruesve faktikë të tokës, sipas këtij neni, ASHK-ja plotëson aktet individuale të kalimit në pronësi, në favor të përfituesve dhe kryen regjistrimin, sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për kadastrën. ...”.

Ndodhur në kushtet kur, ligji 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, parashikon afate për:

- Depozitimin e dokumentacionit nga subjektet e interesuara:

Neni 12, Kushtet për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore, “1. Përfitojnë kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore, subjektet që plotësojnë, njëkohësisht, këto kushte: c) deri në 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë paraqitur kërkesë pranë njërive të vetëqeverisjes vendore për t’u pajisur me AMTP për tokat e ish-kooperativave bujqësore apo ish-ndërmarrjeve bujqësore, pavarësisht nëse janë pajisur ose jo me aktin e marrjes së tokës në përdorim;...”

- Njësitë e vetëqeverisjes vendore

Neni 14, Procedura e kalimit në pronësi pa shpërblim “... 2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, brenda 7 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcjellin pranë ASHK-së kërkesat për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, të administruara sipas ligjeve nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve” dhe nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, si dhe kërkesat e administruara sipas nenit 6 të këtij ligji. ...”.

- Por nuk parashikon afate për përfundimin e shqyrtimit të dokumentacionit nga ASHK; si dhe në kushtet kur rezulton se për rastin konkret institucionet e tjera shtetërore (në rastin konkret Bashkia Himarë), e ka kthyer përgjigjen e saj, do t’i referohemi dispozitave të K.Pr.Administrative, i cili në nenin 91, pika 2, parashikon se, citojmë: “2. Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë”.

Gjithashtu neni 92, po i Kodit të Procedurave Administrative, parashikon se: “1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi. 2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar. 3. Zgjatja e afatit dhe data e përfundimit të afatit të zgjatur i njoftohen palës brenda afatit fillestar. Njoftimi duhet të përmbajë edhe arsyetimin për zgjatjen e afatit”.

Nga dokumentacioni përkatës i administruar në kuadër të këtij hetimi administrativ, nuk rezulton që të jetë bërë zgjatje e afateve të sipërcituara, ndaj duke qenë se edhe nga komunikimi ynë me institucionin tuaj, nuk rezultoi të kishte dokumentacion tjetër, atëherë ndodhemi përpara shkeljes së afateve ligjore, në rastin e trajtimit të kërkesës së familjarëve N.

Ndërkohë sjellim në vëmendje se neni 21, po i K.Pr.Administrative, përcakton se: “Afatet për kryerjen e një veprimi procedural nga palët, të quajtura në vazhdim “afatet procedurale”, përcaktohen nga ligji ose aktet nënligjore. 2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për

kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit”.

Pra, asnjë organ administrativ/institucion shtetëror nuk mund të fillojë një procedurë administrative dhe ta zvarrisë pafundësisht, por duhet ta përfundojë atë brenda një afati të arsyeshëm ligjor. Qëllimi i vendosjes së afateve ligjore dhe respektimi i tyre, është përfundimi sa më shpejt i procedurës administrative dhe brenda një kohe të arsyeshme, në respektim të procesit të rregullt ligjor.

Siç përmendëm edhe më sipër, DVASHK Vlorë, gjatë korrespondencës tashmë pesë vjeçare, nuk na ka vënë në dijeni të ekzistencës së ndonjë shkaku ligjor, i cili do të mund të justifikonte këtë situatë dhe për më tepër, nuk është dhënë asnjë afat kohor se kur planifikohet të përfundojë shqyrtimi i kërkesës së familjarëve N.

Shtojmë se nga dokumentacioni i administruar në kuadër të këtij hetimi administrativ, rezulton se Bashkia Himarë, i ka dërguar dosjet e vëllezërve N., në DVASHK Vlorë, që në datë 15.02.2021, ndaj justifikimi i dhënë në shkresën nr. 6712/1 prot., datë 15.09.2021, të DVASHK Vlorë, lidhur me trajnimin e stafit, nuk është argument ligjor për të justifikuar kohëzgjatjen e paarsyeshme të një procedure administrative, ashtu siç ka adresuar si Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Respektimi i afateve gjatë procesit administrativ përbën bazën e sigurt të çdo rendi juridik ligjor e demokratik pasi:

- procesi administrativ përbën hallkën e parë dhe më të prekshme të procesit ligjor, përmes të cilit qytetari në përpjekje për të fituar apo mbrojtur të drejtat dhe liritë e tij përballet me administratën shtetërore dhe vendore.

- procesi administrativ tregon qartë cilësinë e aksesit në drejtësi, pasi gjatë këtij procesi çdo shtetas kupton dhe percepton më qartë mënyrën se si jepet drejtësia. Mungesa e afateve të arsyeshme në përfundimin e procesit administrativ e bën të paplotë këtë angazhim, duke cenuar drejtpërdrejt të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

- procesi administrativ duke cenuar procesin e rregullt ligjor, ka mohuar garancinë për çdo shtetas ndaj veprimeve të paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe detyrim për këto të fundit që të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, gjatë veprimtarisë së tyre administrative.

- detyrimi për një proces të rregullt ligjor buron edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë, si Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut neni 6 i saj, e cila kërkon detyrimisht aplikim rigoroz nga instrumentet e brendshëm të një shteti.

Në respektim të këtyre parashikimeve, e drejta për një proces të rregullt ligjor është ngritur në nivel Kushtetues, ku konkretisht neni 4, paragrafi 1, parashikon se: “*Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe ligj, nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor*”.

Referuar rastit të paraqitur nga ankuesit, shtojmë se organi administrativ, që duhet të zbatojë detyrimet normative (ligjore dhe nënligjore), përfshirë edhe detyrimin për të përfunduar procedurat dhe dalë me vendim, është DVASHK Vlorë.

Problematika në lidhje me këta ankues, për sa kohë që nuk ka një vendim administrativ lidhur me trajtimin e kërkesës së tyre, prek të drejtat e tyre për t'iu trajtuar çështja brenda afateve të parashikuara nga aktet normative në fuqi, në mënyrë të ligjshme, transparente, të paanshme, të drejtë, por prek edhe të drejtën e tyre për t'u informuar për veprimtarinë e organeve shtetërore.

Këto janë të drejta të parashikuara jo vetëm nga Kodi i Procedurave Administrative (nenet 4, 5, 6, 10, 13, 15, 18/2, etj.), por së pari nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila në:

- Nenin 23, pika 2, parashikon: *“2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, ...”*.
- Neni 42, pika 1, parashikon: *“Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor”*.
- Neni 15, pika 2, parashikon se: *“organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”*.

Veprimet (apo mosveprimet) e mësipërme, siç përmendëm edhe më sipër, e vendosin institucionin tuaj përpara shkeljes së procesit të rregullt ligjor, në zhvillimin e këtij procesi administrativ, ndaj vlerësojmë se institucioni juaj duhet të përmbushë detyrimet ligjore në lidhje me procedurat, duke shmangur vonesat e panevojshme, që mund të jenë shkaktuar nga: inercia, neglizhenca apo zvarritja e qëllimshme e procesit, pasi Institucioni i Avokatit të Popullit ka mandat të vlerësojë jo vetëm veprimet e paligjshme të administratës publike por edhe veprimet e parregullta të saj.

Gjithashtu si Kodi i Procedurave Administrative, ashtu edhe aktet e tjera normative që rregullojnë punën e institucionit tuaj, parashikojnë detyrime për DVASHK-të, që të jenë transparente në ushtrimin e veprimtarisë së tyre, pasi krahas mundësimit të së drejtës së informimit, ato duhet të ndërmarrin veprime konkrete dhe të zbatojnë programe efikase informimi (si për aplikuesit, ashtu edhe për publikun e gjerë), lidhur me efektet e ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e përditshme të këtij institucioni.

Informimi dhe ndihma që i duhet dhënë shtetasve, janë jo vetëm detyrime ligjore (Kodi i Procedurave Administrative, neni 10 - *Parimi i dhënies së ndihmës aktive*: *“1. Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre. 2. Organi publik promovon mundësinë e palës për të aksesuar autoritetin publik në mënyrë elektronike. Kjo mundësi nuk është e lidhur me ndonjë detyrim të palës për të përdorur mjete të komunikimit elektronik. 3. Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që padija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që pala gëzon sipas ligjit”*), por në vlerësimin e institucionit tonë edhe elementë shumë të rëndësishëm, për garantimin e përfundimit me sukses të proceseve kalimtare të pronësisë.

Mospërfundimi i procesit nga ana e institucionit tuaj, nuk gjen asnjë justifikim ligjor apo të arsyeshëm dhe mbi të gjitha cenon edhe parimin e sigurisë juridike në një shtet demokratik. Kjo për arsye se parimi i sigurisë juridike presupozon besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe jo vetëm pandryshueshmërinë e legjislacionit për marrëdhëniet e rregulluara, por edhe garantimin e ligjshmërisë së veprimeve që shteti kryen me qytetarët e tij, sigurinë juridike se

qytetari është objekt i veprimeve të ligjshme dhe se institucionet shtetërore do i garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të tij.

Institucioni ynë duke pasur parasysh rëndësinë e zgjidhjes së problemeve të pronësisë, si në raport me garantimin e të drejtës së pronësisë së shtetasve, ashtu edhe për zhvillimin ekonomik të vendit, në rastet kur konstaton vonesa në trajtimin e praktikave, jo vetëm përtej afateve ligjore, por edhe përtej çdo afati të arsyeshëm, rekomandon marrjen e masave sistematike, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve konkrete dhe jo të lihen pa trajtuar kërkesat e shtetasve, jo vetëm përtej afateve ligjore, por edhe përtej çdo afati të arsyeshëm.

Nuk do të ndalemi në analizën me hollësi të konceptit të *afatit të arsyeshëm*, pasi e kemi trajtuar në një sërë Rekomandimesh që i kemi dërguar DVASHK-së tuaj, por edhe për këtë rast konkret jemi të mendimit se kjo vonesë nuk mund të konsiderohet aspak si e arsyeshme. Siç kemi përmendur edhe në Rekomandime të mëparshme, mosshqyrtimi administrativ i aplikimeve të shtetasve (pavarësisht llojit të shërbimit kadastral) brenda afateve ligjore dhe/ose atij të arsyeshëm, në varësi edhe të rrethanave të tjera të çështjes, mund të përbëjnë shkak për nisjen e një procesi për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga kohëzgjatja e pajustifikuar e procedurës administrative.

Në analizë të parashikimeve të mësipërme, rezulton se ankuesi, për shkaqe të pavarura nga ai, nuk arrin të marrë një vendim përfundimtar në një procedurë administrative, në një kohë që ka respektuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni përkatës,

Institucioni ynë vlerëson se vonesa në trajtimin e praktikës së familjarëve N., kufizon liritë dhe të drejtat e tij të garantuara nga Kushtetuta dhe ligji, e më konkretisht, të drejtën e pronësisë.

Institucioni ynë përsërit se shkelja e të drejtave të mësipërme, sjell në marrëdhënie me shtetasit një sërë problematikash, duke filluar që nga: *humbja e besimit të qytetarëve tek organet e administratës publike*, e deri tek *rreziku i përballjes së organeve të administratës shtetërore me padi civile për dëm jashtëkontraktor*, që mund t'i jetë shkaktuar shtetasve, nga shkelja e të drejtave të sipërpërmendura.

Nisur nga fakti që gjatë punës tonë, tashmë prej kohësh kemi konstatuar edhe mjaft raste të tjera, të trajtimit nga ana e DVASHK Vlorë të kërkesave të shtetasve në tejkalim të theksuar të afateve ligjore të sipërcituara, në mbështetje të nenit 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit: “3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.....”, si dhe nenit 21, gërma b, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, sipas të cilit: “Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime:... b) paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave për shqyrtimin dhe përfundimin pa vonesa të mëtejshme, të procedurës administrative, që lidhet me kërkesën e vëllezërve S. dhe K. N.

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, “Detyrimi i organeve të administratës për t’ju përgjigjur rekomandimeve të

Avokatit të Popullit”, sipas të cilit: “Organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigjja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ. Avokati i Popullit duhet të njoftohet dhe ka të drejtë të marrë pjesë e të flasë në mbledhjet e organeve kolegjiale të administratës publike, ku merret në shqyrtim rekomandimi, kërkesa apo propozimi i tij”, lutemi të na vini në dijeni mbi zbatimin e këtij Rekomandimi, brenda afatit ligjor të sipërcituar.

Duke ju falënderuar paraprakisht,

K O M I S I O N E R E

Erinda MELI